

LIGJI 06/L-043 PËR LIRI TË ASOCIIMIT NË OJQ - PËRMBLEDHJE

PROBLEMET KRYESORE TË VERZIONIT TË MIRATUAR NË 7 NËNTOR 2018

SHKATËRROHET PARIMI JO PËR PËRFITIM

për shkak të ndryshimit të bazës së shpërndarjes së pasurisë së OJQ-ve pas shuarjes, duke mundësuar shpërndarjen e pasurisë së OJQ-së jashtë sektorit jo-qeveritar, përfshirë në sektorin privat (Neni 41.2, Amandmaneti 31)

- "Institucionet" (si publike ashtu edhe private) janë shtuar si pranues të mundshëm të pasurisë së OJQ-së së shuar;
- Dispozita e re është në kundërshtim me parimin fundamental jo për përfitim të OJQ-ve, duke mundësuar shpërndarjen e pasurisë së OJQ-së jashtë sektorit jo-qeveritar, përfshirë në sektorin privat;
- Dispozita e re është në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO 97/12 për Ligjin për Bankat, lidhur me nismën për lejimin e transformimit të OJQ-ve mikrofinanciare;

PASOJAT E DREJTPËRDREJTA

Mundësimi i transferimit të aseteve të OJQ-ve në sektorë të tjerë (përfshirë institucionet private) do të:

1. Lejojë që kapitali i OJQ-ve mikrofinanciare të transferohet të bizneset private, pasi që këto OJQ fillimisht të mbyllën vullnetarisht;
2. Lejojë që secila OJQ të transferojë pasuritë/kapitalin te bizneset private, pas që këto OJQ fillimisht të jenë mbyllur vullnetarisht;
3. Lejojë që çdo grant qeveritar, apo nga donatorët tjerë të huaj apo vendor, që jepet për OJQ ta ketë rrugën e ligjshme për t'u transferuar te bizneset private
4. Parandalojë donatorët nga garancionet e domosdoshme ligjore që donacionet e tyre do të përdoren për qëllimet jo për përfitim, rrjedhimisht rrezikon ndërprerjen e çfarëdo përkrahje për OJQ-të në Kosovë.

FAKTE

Parimet ndërkombëtare

Çdo pasuri e OJQ-së shfrytëzohet vetëm për misionin e OJQ-së. Kur OJQ shuhet, pasuria e mbetur i kalon një OJQ-je me mision të njejtë ose të ngjashëm.

(Udhëzuesi i Komisionit të Venedikut për lirinë e asociimit dhe dokumente tjera të ngjashme)

Ligji për OJQ

OJQ nuk shpërndan të ardhura neto ose fitime për asnjë person. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e OJQ-së përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të përcaktuara për organizatën. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e OJQ-së nuk përdoren për të sjellë drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar, punonjës ose donatorë të OJQ-së, përveç pagesës për personat që kryejnë punë për organizatën.
(Neni 12, Ligji 06/L-043 për Liri të Asociimit në OJQ)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Gjykata rikujton se pasuritë që janë pronë e OJQ-ve mund të shfrytëzohen vetëm në funksion të përmbushjes së qëllimeve dhe të objektivave mbi të cilat janë themeluar OJQ-të, në përputhje me parimin e shpërndarjes jofitimprurëse. Prandaj, transferimi i pronësisë mbi pasuritë e OJQ-ve për çdo person fizik apo juridik, do të jetë kundër këtij parimi.

(Pika 132, Aktgjykim i datës 12 prill 2013 në rastin Nr. KO97/12 për Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare)

MUNDËSOHET MBYLLJA ARBITRARE E OJQ-VE

për shkak të ndryshimit të bazës së shuarjes së OJQ-së nga jo-solvente në jo-aktive (Neni 41, Amandamenti 30)

- Në dispozitën e shuarjes së OJQ-ve, fjala “jo-solvente” është zëvendësuar me fjalën “jo-aktive” (Neni 41.1)
- Jo-solvenca është pa-afhtësia për të paguar, definohet në Ligjin për falimentim dhe ka karakter financiar;
- Jo-aktiviteti është koncept jo-financiar, nuk definohet as në legjislacionin kosovar e as në praktikën ndërkombëtare, e as që ka mundësi të matet apo konstatohet.

PASOJAT E DREJTPËRDREJTA

Lejimi i “jo aktivitetit” si kriter për shuarjen e OJQ-ve do të:

1. Krijohë mundësi të drejtpërdrejtë për vendime arbitrare në raport me shuarjen e OJQ-ve dhe rrezikon të drejtën kushtetuese të lirisë së asociimit;
2. Lejojë që shteti të interpretojë pa ndonjë bazë se cilat OJQ janë aktive e cilat jo;
3. Lejojë që shteti të ketë mundësi që të mbyllë OJQ-të në mënyrë arbitrare bazuar në interpretimet e pabazuara;
4. Krijohë pasiguri juridike dhe paparashikueshmëri për OJQ-të në Kosovë lidhur me të ardhmen e tyre.

FAKTE

Parimet ndërkombëtare

Vendimi i plotfuqishëm i gjykatës është baza e vetme legjitime për shuarjen e një organizate (Udhëzuesi i Komisionit të Venedikut për lirinë e asociimit, Pika 242)

Ilustrim i interpretimit arbitrar të jo-aktivitetit

Një OJQ ose rrjet i OJQ-ve është themeluar vetëm për monitorimin e zgjedhjeve. Normalisht, kjo OJQ pritet të aktivizohet vetëm kur ka zgjedhje, cdo 4 vite, ndërsa gjatë 3 viteve të ndërmjetme nuk ka nevojë që të zhvillojë ndonjë aktivitet. Bazuar në dispozitën e re, shteti mund ta mbyllë këtë OJQ disa muaj para zgjedhjeve të radhës, me arsyetimin që “nuk ka qenë aktive për 3 vite me radhë”.

(Rast ilustrues i bazuar në realitetin e veprimitarisë së OJQ-ve në Kosovë dhe më gjerë)

PROCESI

- I hartuar gjatë viteve 2016-2017, me përfshirje të gjerë institucionale dhe të shoqërisë civile dhe me ekspertizë vendore e ndërkombëtare;
- I bazuar në Udhëzuesin e Komisionit të Venedikut për liri të asociimit të vitit 2014;
- I bazuar në analiza të thella të praktikës së zbatimit të ligjit aktual në Kosovë;
- I ndërtuar mbi konsensusin ndërsektoral të krijuar nëpërmjet diskutimeve të shumta;
- I miratuar nga Qeveria e Kosovës në dhjetor 2017;
- I miratuar në lexim të parë nga Kuvendi në mars 2018;
- I diskutuar në dëgjim publik nga Komisioni për Media dhe Administratë Publike në prill 2018;
- I miratuar në lexim të dytë më 7 nëntor, me 36 amandamente (shumica nga to restriktive);
- I kthyer nga Presidenti, pas kërkesës nga KCSF dhe 76 OJQ tjera, më 23 nëntor 2018;

KËRKESA E SHOQËRISË CIVILE

Aprovimi në lexim të tretë sipas kërkesave të shoqërisë civile, respektivisht të gjitha amandamenteve të propozuara nga Presidenti.